

PËRMBLEDHJE UDHËZUESISH PRAKTIK NGA MuSPP: UDHËRRËFYESI YNË DREJT VETËQËNDRUESHMËRISË

SHËNIM PËR SHFRYTËZUESIT

Çka është përmbledhja e udhëzuesve praktik nga MuSPP?

Përmbledhja e udhëzuesve praktik nga MuSPP është një përmbledhje e instrumenteve bazuar në përvojën e krijuar ndër vite në kuadër të kontekstit kosovar, i cili përmban doracakë, udhëzues të përcjellur me përvojat më të mira nga rastet e studimit, mjetet për menaxhimin e projekteve dhe termat e referencës (ToR). Përmbledhja në fjalë, duhet të shihet dhe të shfrytëzohet si një resurs nga ana e institucioneve kompetente që merren me proceset e planifikimit hapësinor, mjedisor, dhe të menaxhimit, si dhe me aplikimin e planifikimit pjesëmarrës dhe gjithëpërfshirës në adresimin e çështjeve të ndryshme. Për më tepër, përmbledhja shërben si një burim unik për zgjidhje të mençura dhe inovative në planifikimin hapësinor bazuar në përvojat në kuadër të kontekstit lokal.

Cili është qëllimi i përmbledhjes?

Përmbledhja, si pjesë e trashëgimisë së MuSPP-it ka për synim t'iu mundësojë planerëve komunal që t'i kryejnë aktivitetet përmes qasjes "me kapacitete vetanake" në një nivel të planifikimit hapësinor, duke i vënë në përdorim teknikat moderne të planifikimit hapësinor dhe proceset e planifikimit pjesëmarrës. Përmbledhja gjithashtu i mundëson grupeve të komunitetit dhe palëve të interesit/akterëve që të kuptojnë më mirë rolin e tyre dhe nivelin e kontributit të pritur gjatë procesit të planifikimit.

Përmbledhja më tej shërben si një mjet për transferimin e njohurisë nga MuSPP me qëllim të konsolidimit të kapaciteteve institucionale dhe fuqizimit të koordinimit institucional, integritetit të çështjeve gjinore dhe pjesëmarrjes publike në planifikimin hapësinor, si dhe ngritjes së vetëdijës mbi rëndësinë e planifikimit hapësinor dhe rolet e akterëve përkatës në proces.

Kujt do t'i shërbejë kjo përmbledhje?

Përmbledhja ka për synim t'iu shërbejë një spektri të gjerë të palëve të interesit/akterëve, përfshirë institucionet qeveritare të nivelit qendror dhe lokal, si lidërsipin politik ashtu dhe stafin teknik, organizatat jo-qeveritare, universitetet, sektorin privat (ndërmarrjet e vogla dhe të mesme), asociacionet profesionale, shoqërinë civile dhe grupet vështirë të qasshme siç janë personat me nevoja të veçanta, grupet minoritare dhe të rinjtë.

Çka përfshihet në këtë përmbledhje?

Përmbledhja e MuSPP-it është e ndarë në pesë fokus tema të listuar në vijim, ku secila prej tyre përfshin një numër mjetesh si dhe përmbajtjen e tyre. Përmbledhja gjithashtu do të vendoset në ueb-faqen e UN-Habitat-it, Kosovë, <http://www.unhabitat-kosovo.org>. Sidoqoftë, disa prej përmbajtjeve të mëposhtme, mund të përditësohen apo të revidohen në mënyrë që të përputhen me trendët e fundit dhe ndryshimet legjislative që mund të pasojnë.

A. QASJA GJITHËPËRFSHIRËSE DHE PJESËMARRËSE NË PLANIFIKIMIN HAPËSINOR

1. Doracaku për Vizionim

Doracaku ofron një kuptim të duhur të rolit dhe procesit të vizionimit si mjet i planifikimit pjesëmarrës. Doracaku gjithashtu përshkruan në detaje nocionin e 'vizionit me komunitet' bazuar në një sërë parimesh, instrumentesh dhe udhëzuesish, kryesisht me bazë në literaturën dhe përvojat ndërkombëtare më të mira. Ky doracak përshkruan mënyrat dhe hapat e ndryshëm për organizimin e punëtorisë së vizionimit, përfshirë metodat dhe teknikat më specifike me rezultate të dëshmuara. Dokumenti poashtu prezanton përvojën e vizionimit në Kosovë, siç janë shembujt që përshkruajnë implikimet (in)direkte për autoritetet e planifikimit dhe përfituesit nga ky proces, sidomos të kuptuarit e 'pse, si, dhe për çka?'.

2. Udhëzues për integrimin gjinor në planifikimin hapësinor

Udhëzuesi promovon qasjen e integritit gjinor në praktikën e planifikimit hapësinor në formën e 'një qasje hap-pas-hapi për komunitet'. Në mënyrë fleksibile, udhëzuesi përshkruan dhe ilustron mënyrat dhe fazat e ndryshme të përfshirjes së perspektivës gjinore në proceset e planifikimit shikuar nga perspektiva e politikave dhe e veprimit. Udhëzuesi poashtu prezanton shembuj nga rastet e studimit nga komunitet e Kosovës, dhe përshkruan mësimet e nxjerra, në bazë të të cilave janë dhënë një sërë rekomandimesh për integrimin gjinor. Udhëzuesi demonstroi në mënyrë praktike se pse dhe si të përfshihen gratë dhe vajzat, burrat dhe djemtë në procesin e mëtutjeshëm, demokracinë lokale dhe transparencën si elemente kyçe për politika dhe projekte adekuate. Udhëzuesi përmban edhe një listë të hapave për projektet gjinore dhe dokumentet politike si dhe poashtu format për vlerësim dhe analizë.

3. Udhëzues për pjesëmarrjen publike në planifikimin hapësinor

Udhëzuesi për përfshirjen e shoqërisë civile në procesin e planifikimit hapësinor iu drejtohet në radhë të parë institucioneve të nivelit qendror dhe lokal dhe organeve të tjera qeveritare të cilët janë direkt të përfshirë në procesin e hartimit të dokumenteve të planifikimit hapësinor në mënyrë pjesëmarrëse, gjithëpërfshirëse, dhe me konsideratë ndaj çështjeve gjinore. Udhëzuesi gjithashtu ka për synim të rrisë njohurinë dhe kapacitetet e atyre që punojnë në fushën e qeverisjes urbane dhe planifikimit të qytetit duke përmirësuar dhe ndihmuar në institucionalizimin e qasjeve të tilla pjesëmarrëse.

Udhëzuesi gjithashtu mund të shërbejë si burim i informacionit për palët e tjera të interesit. Ai përbën pjesën e një dokumenti më të gjerë i cili merret me kërkesat ligjore të dokumenteve të planifikimit hapësinor siç parashihet në Ligjin për Planifikimin Hapësinor dhe aktet nën-ligjore përkatëse. Qëllimi është që ky udhëzues të jetë sa më praktik, por gjithashtu të prezantojë një teori bazë që mund të shfrytëzohet nga ata të cilët nuk e kanë pasur mundësinë më herët të punojnë me çështjet e pjesëmarrjes publike.

B. PLANIFIKIMI HAPËSINOR DHE MENAXHIMI

1. Udhëzues për hartimin e Planeve Zhvillimore Komunale

Udhëzuesi jep udhëzime për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e Planeve Zhvillimore Komunale (PZHK-të) nën prizmën e Ligjit të ri për Planifikimin Hapësinor. Udhëzuesi është hartuar si një orientim për komunat e Kosovës, bazuar në mbështetjen dhe përvojën e MuSPP-it me komunat partnere dhe në kontekstin e tyre specifik. Dokumenti paraqet në detaje metodologjinë për hartimin e PZHK-ve në Kosovë, dhe një numër rekomandimesh dhe idesh se si PZHK-të duhet të reflektojnë në gjithë sektorët dhe çështjet reciproke.

PZHK-të janë dokumente esenciale për planifikimin e zhvillimit dhe menaxhimit të ardhshëm të territorit të Kosovës. Si të tilla, këtu jepen udhëzime shtesë që janë të nevojshme për hartimin e të gjitha fazave të PZHK-së, duke përfshirë zbatimin, monitorimin & vlerësimin.

2. Raporti i vlerësimit të zbatimit – Plani Zhvillimor Komunal

Shembulli i Komunës së Junikut

Raporti ofron një shembull të qasjes konvencionale drejt vlerësimit të zbatimit të Planit Zhvillimor Komunal (PZHK).

Metodologjia e vlerësimit është bazuar në Planin e Veprimit për zbatimin e PZHK-së, dhe është veçanërisht i shfrytëzueshëm në rastet e mungesës së raporteve të rregullta vjetore të monitorimit dhe vlerësimit, por gjithashtu mund të shfrytëzohet edhe në rastet kur raportimi i rregullt për progresin e zbatimit të PZHK-së është vënë në funksion, nga të gjitha komunat e Kosovës.

3. Udhëzues për menaxhimin e zhvillimit

Shembulli i Komunës së Mamushës

Udhëzuesi përmes qasjes hap-pas-hapi prezanton procedurën për lëshimin e kushteve ndërtimore, lejes ndërtimore, certifikatës së përdorimit dhe trajtimit të ndërtimeve pa leje. Udhëzuesi është hartuar për Komunën e Mamushës, por përmbajtja e dokumentit është pjesërisht e aplikueshme për komunat tjera të Kosovës. Qëllimi i udhëzuesit është të shërbejë si një dokument orientues i cili do t'iu lehtësojë punën institucioneve lokale për zbatimin e Ligjit për Ndërtim dhe Ligjit për Trajtimin e Ndërtimeve pa Leje. Për më tepër, shikuar nga perspektiva lokale, udhëzuesi parasheh kriteret të përgjithshme për zhvillimin e secilës zonë në Mamushë në përputhje me dispozitat e Planit Zhvillimor Komunal.

Udhëzuesi është i përcjellur me një fletushkë, të hartuar për Komunën e Mamushës, por fokusohet tek komunitetet dhe institucionet e planifikimit në nivel lokal në gjithë Kosovën. Fletushka ka për qëllim t'iu prezantojë procedurat për dorëzimin dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte dhe leje ndërtimore, të cilat derivojnë nga Udhëzimi Administrativ nr.10/2013 për zbatimin e Ligjit për Ndërtim nr.04/L-110.

C. PLANIFIKIMI SEKTORAL - BANIMI

1. Profili Komunal i Banimit

Shembulli i Komunës së Gjilanit

Profili Komunal i Banimit në Gjilan paraqetshembullin e hapit të parë drejt zhvillimit të politikave të banimit në nivel lokal. Profili përbëhet nga të dhënat dhe analizat gjithëpërfshirëse të trendeve të banimit në komunë, që përshkruajë karakteristikat e banimit (tipologjia, fondi, zotërimi, toka, infrastruktura) dhe ndërlihdjen e kërkesës dhe ofertës, si dhe çështjet relevante për komunat e Kosovës, duke përfshirë zhvillimit e fondit të banimit, ripërtëritjen dhe përbalueshmërinë financiare.

2. Udhëzuesi për hartimin e Profilit Komunal të Banimit

Ky dokument ofron udhëzime të qarta dhe koncize për autoritetet komunale në procesin e hartimit të Profilit Komunal të Banimit, duke përfshirë përmbajtjen, analizën e akterëve/palëve të interesit, mbledhjen e të dhënave, si dhe analizat dhe metodologjitë për pjesëmarrje me qëllim të pasurimit dhe vlefshmërisë së profilit. Udhëzuesi përcakton bazën për zhvillimin e mëtejshëm të politikave të banimit (strategjitë e banimit) dhe programeve afat-shkurta dhe afat-gjata të synuara (p.sh. programet e banimit social) në nivel komunal në Kosovë.

D. PLANIFIKIMI DHE MENAXHIMI MJEDISOR

1. Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Termtat e Referencës për shërbime të konsulencës

Duke pasur parasysh se Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) është një fushë e re teknike me boshllëqe sa i përket profesionistëve mjedisor që mund ti kryejnë VSM-të në Kosovë, qëllimi i Termave të Referencës (TeR) është tu sigurojë komunave një kornizë për angazhimin e profesionistëve të kualifikuar dhe/ose monitorimin e punës së tyre, duke përcaktuar qartë angazhimet, detyrat kyçe dhe rezultatet e pritura për planet hapësinore dhe hartat e zonimit, si dhe duke siguruar se çështjet mjedisore janë të integruar në mënyrë adekuate në strategjinë komunale të planifikimit hapësinor, masat e zbatimit dhe proceset e monitorimit. TeR për shërbime të konsulencës për VSM kanë për qëllim përfundimtar mbështetjen e punës së institucioneve të nivelit lokal dhe qendror në hartimin e VSM-ve për planet hapësinore.

2. Udhëzuesi për hartimin e Vlerësimi Strategjik Mjedisor

Ky udhëzues rezulton nga përvoja e MuSPP-it në mbështetjen e proceseve të planifikimit hapësinor dhe mjedisor në Kosovë. Ai ka për qëllim të ndihmojë qeverinë qendrore dhe lokale duke ofruar rekomandime për zbatimin e Vlerësimi Strategjik Mjedisor (VSM) në Kosovë, pas miratimit të

Direktivës së Bashkimit Evropian për VSM 2001 në legjislacionin e Kosovës, dhe në veçanti në lidhje me proceset e planifikimit hapësinor.

Ky udhëzim është hartuar në mënyrë që ti inkurajojë shfrytëzuesit të marrin në konsideratë ndikimet mjedisore të planeve dhe programeve në kontekste të veçanta të planifikimit hapësinor. Gjetjet nga proceset e para të VSM-ve në Kosovë kanë vendosur bazën për udhëzimet që ofrojnë mësim të rëndësishme për komunitete të tjera, si në Kosovë ashtu dhe në rajonin e Ballkanit, pasi ato konsiderojnë opsione të ndryshme për planifikimin e mjedisit dhe të zhvillimit të integruar. Më tej në vlerësimin e planit, vlerësimi i mjedisit në kontekstin e Kosovës ofron mundësi për të rritur vëmendjen ndaj mjedisit në planifikim. Ai gjithashtu përfshin një sërë masash për monitorimin dhe zbutjen e pasojave, për t'u zhvilluar më tej nga ana e komunave gjatë zbatimit të planeve të tyre të zhvillimit lokal, si pjesë e një qasjeje të integruar për planifikim efektiv të zhvillimit të qëndrueshëm. Për ta mbështetur këtë udhëzues, shembujt e mëposhtëm për VSM gjithashtu janë përfshirë:

Raporti i VSM-së për PZHK-në e Mamushës

Raporti i VSM-së për PZHK-në e Parteshit

Raporti i VSM-së për PZHK-në e Prizrenit

3. Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave

Shembulli i Komunës së Hanit të Elezit

Plani Lokal i Menaxhimit të Mbeturinave (PLMM) është një tjetër dokument obligativ i planifikimit që del nga Ligji për Mbeturina 04 / L-060, i cili duhet të jetë në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Menaxhimin e Mbeturinave (2012-2021) dhe Planin e Veprimit për periudhën 2013-2017. Si rrjedhojë, komuna e Hanit të Elezit, e mbështetur nga MuSPP, e ka rishikuar PLMM në përputhje me kërkesat e legjislacionit të ri. Prandaj ky PLMM ofron një qasje që do të shërbejë si shembull për komunat e Kosovës në hartimin dhe rishikimin e planeve të tyre përkatëse.

Plani analizon gjendjen e tanishme, përcakton objektivat dhe përkufizon masat për përmirësimin dhe mbështetjen e grumbullimit, menaxhimit dhe trajtimit të mbeturinave (duke përfshirë riciklimin dhe kompostimin), mundësitë e financimit (duke përfshirë planin e mbulimit të kostos), dhe përfundimisht përcakton disa udhëzime rregullative dhe zbatimin përkatës. Në këtë mënyrë, ky plan poashtu shërben si një udhëzues për zvogëlimin e sasisë, trajtimin, dhe shkarkimin e mbeturinave gjatë projekteve të ndërtimit, renovimit, apo pastrimit të tokës.

4. Raporti mbi Studimin e Drunjve dhe Menaxhimin e Gjelbër

Në lidhje me Projektet e Investimeve Kapitale

Raporti shqyrton një numër shembujsh të Projekteve të Investimeve Kapitale, në aspekt të ruajtjes, përmirësimit dhe menaxhimit të infrastrukturës së gjelbër, dhe si rezultat ofron një numër të detyrave dhe rekomandimeve që duhet përcjellen, të cilat në të ardhmen do të shërbejnë si udhëzim për rritjen e infrastrukturës së gjelbër në zonat urbane në tërë Kosovën, si dhe menaxhimin përkatës.

E. PROJEKTET E INVESTIMEVE KAPITALE (PIK)

1. Udhëzuesi për menaxhimin e Projekteve të Investimeve Kapitale

Mësimet e nxjerra nga MuSPP

PIK përbëjnë një fushë të rëndësishme që mbështetet nga MuSPP, dhe paraqesin asete të prekshme që rezultojnë nga proceset e planifikimit hapësinor. Veçanërisht është punuar shumë në përmirësimin e hapësirave publike. Ky udhëzues është i bazuar në mësimet e nxjerra të MuSPP-it dhe ka për qëllim të ofrojë një sërë këshillash praktike për ciklin e PIK.

Identifikimi, projektimi, zbatimi dhe mirëmbajtja e PIK janë procese të ndërlikuara që përfshijnë jo vetëm stafin e komunës, por edhe komunitetin e biznesit, organizatat tjera qeveritare dhe jo-qeveritare, si dhe shoqërinë civile.

Ky udhëzues hap-pas-hapi përmban të dhëna të dobishme dhe praktike mbi rolet dhe përgjegjësitë e të gjithë akterëve gjatë procesit, të mjeteve metodologjike dhe kronologjisë së detyrave, si dhe listat e hapave “prej A deri në Zh” që mundësojnë realizimin e PIK-ut. Disa raste studimi në komunat partnere të MuSPP-it ofrojnë një perspektivë shtesë në demonstrimin e suksesit të proceseve të tilla.

2. Shndërrimi i Hapësirave në Vende - Doracak

Si plotësim për Udhëzuesin për Menaxhimin e Projekteve të Investimeve Kapitale, ky doracak përshkruan veçoritë kryesore të dizajnit të "vendeve të mira publike", duke prezentuar disa koncepte globale dhe shembuj lokalë. Ky doracak gjithsesi synon nxitjen e diskutimit, ideve, mendimit kolektiv dhe rritjen e vetëdijes tek vendimmarrësit për raportin në mes krijimit të vendeve dhe mirëmbajtjes së hapësirës.

Ky doracak qartë shpjegon se çka është krijimi i vendeve, se si mbi të gjitha krijimi i vendeve ndikon në jetërat e njerëzve, dhe si mund të arrihet ai. Doracaku zhvillon disa parime dhe teknika të dizajnit dhe përmban shembuj të gjallë dhe frymëzues që dalin nga PIK të zbatuara në komunat partnere të MuSPP.

Shënim: Ju lutemi vizitoni ueb-faqen periodikisht për ta përditësuar përmbledhjen tuaj.